

RECON

RE-valuation of Cultural-Heritage,
Knowledge and Opportunity Network

A e dini se projekti RECON u ofroi katër kineastëve të rinj mundësinë për të bërë një film të shkurtër duke përdorur ekskluzivisht materiale arkivore të koleksioneve nga *Kinemateka e Malit të Zi dhe Arkivi Qendror Shtetëror i Filmit?*
Le t'i zbulojmë së bashku!



Jehona

Me skenar dhe regji nga *Dario Haruni*

Filmi trajton marrëdhënien midis fesë dhe besimit në një mënyrë jungiane, duke kërkuar një mënyrë për të gjetur unitetin midis këtyre dy polariteteve.

[Klikoni këtu për të parë trailerin zyrtar të filmit!](#)

Dario Haruni

Dario Haruni është një regjisor dhe videograf 25 vjeçar nga Tirana, me një interes të madh për psikologjinë, letërsinë, mitologjinë, teologjinë dhe filozofinë. Ai është diplomuar në regji filmi dhe aktualisht është duke studiuar për MSc në Psikologji Komunitare.



Pse Kështu?


Me skenar dhe regji nga *Una Jovović*

Kjo vepër si koment social është tragjike dhe komike në të njëjtën kohë në trajtimin e kujtesës kolektive traumatike të shqiptarëve nën sundimin totalitar të liderit komunist Enver Hoxha.

[Klikoni këtu për të parë trailerin zyrtar të filmit!](#)

Una Jovović

Una Jovović është artiste multimediale 32 vjeçare, e cila filloi si fotografe dhe vazhdon karrierën si arkeologe e medias. Nga fotografia e palëvizshme e kohës së sotme, ajo ka zhvilluar kreativitetin e saj si një studiuese krijuese e imazheve lëvizëse që kanë të bëjnë me të kaluarën tonë.



Limonë & Portokaj

Me skenar dhe regji nga *Enxhi Noni*

Është verë, një ditë në jetë nën vapën e madhe. Ky është një udhëtim arkivor nëpër palë të ndryshme sysh dhe shtresa të ndryshme të lëkurës - të gjitha me shpresën për të gjetur një vend ku të uleni dhe të mos bëni asgjë.

[Klikoni këtu për të parë trailerin zyrtar të filmit!](#)

Enxhi Noni

23 vjet rreth diellit, në një kërkim për të bredhur kudo në Evropë derisa të mos ketë më faqe pasaportash falas për të vulosur një vizë tjetër. Aktualisht me bazë në Bruksel, Belgjikë, Enxhi është duke ndjekur një Master në Antropologji Sociale dhe Kulturore.



një poezi në ditë e mban luftën larg


Shkruar dhe drejtuar nga *Tamara Pavićević*

Historia shqiptare e shekullit të 20-të e rrëfyer me thjerrëzën poetike të një të huaji. A mund t'i falim njerëzit që erdhën para nesh që nuk bënë mjaftueshëm?

[Klikoni këtu për të parë trailerin zyrtar të filmit!](#)

Tamara Pavićević

Regjisore filmit, producente dhe artiste e videove me një portofol me filma të shkurtër fiction, dokumentarë dhe video instalacione. Puna e saj shpesh portretizon mënyrat se si njerëzit përballen me përvojat traumatike. Aktualisht po përfundon studimet master për regji filmi.



Festivali i Filmit Ubrzaj 2022 në Mal të Zi, i pari dhe i vetmi i këtij lloji, i dedikuar sektorit të filmit dhe i fokusuar në dëshirën për të komunikuar çështjet e të drejtave të njeriut përmes kinemasë, u zhvillua në Podgoricë nga 10 deri më 14 dhjetor. Në edicionin e sivjetshëm të Festivalit, ndër të tjera, janë përzgjedhur dhe i janë prezantuar publikut katër filmat me metrazh të shkurtër të realizuar falë **projektit RECON**.

